



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.2/22

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit .....dhe referentit ....., duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruesve të ankesës Xh. Sh. dhe I. N., që të dy avokat në Prishtinë, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 01.03.2022, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e ankuesve Xh. Sh. dhe I. N., që të dy avokat në Prishtinë, e parashtruar ndaj gjyqtarit .....dhe referentit ....., **SI E PABAZUAR.**

### A r s y e t i m

Me datë 03.02.2022, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vepruar konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoritetit kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga Xh. Sh. dhe I. N., që të dy avokat në Prishtinë ndaj gjyqtarit .....dhe referentit ....., me arsyetimin se në lëndën C.nr.1392/20, këtu parashtruesve të ankesës, si përfaqësues të palës paditëse, ju është refuzuar propozimi për caktim të masës së sigurisë me Aktvendimin C.nr.1392/20, të datës 24.12.2021, të cilin vendim e kanë pranuar me datë 30.12.2021 dhe të njëjtën datë kanë paraqitur ankesë dhe kanë paguar taksën gjyqësore për ankesë. Me datë 14.01.2022, duke respektuar afatet ligjore nga neni 187 dhe 188 të LPK-së, janë interesuar se a është dërguar lënda në Gjykatën e Apelit dhe nga referenti i kësaj gjykate janë njoftuar se lënda nuk mund të dërgohet në Gjykatën e Apelit edhe një muaj e gjysmë sepse janë të ngarkuar, të njëjtit kanë theksuar se një arsyetim i tillë është i papranueshëm për arsye se lënda është e natyrës urgjente por edhe duke pas parasysh raportet e acaruar mes palëve është e kuptueshme se çdo vonesë mund të rezultojë me dëmtim pa masë të palës paditëse kjo për faktin se ekziston dyshimi i bazuar se këto vonesa janë të qëllimshme dhe vonesat e tilla do të ndikojnë në ndryshimin e gjendjes faktike aktuale dhe rrezikimin e përmbushjes së kërkesës së palës propozuese/paditëse dhe se me këto vonesa po i jepet mundësi dhe kohë palës kundërshtarë që të bëjë tjetërsimin e pasurisë që është objekt kontesti. Andaj, të njëjtit kanë ngritur dyshimet se procedura është duke u zvarritur me qëllim dhe për interesa personale nga ana e zyrtarit të administratës së kësaj gjykate në bashkëpunim me gjyqtarin .....dhe se bazuar në të gjitha kërkesat dhe paralajmërimet rezulton se gjyqtari dhe referenti në fjalë me dashje dhe me qëllim nuk po e procedojnë lëndën në Gjykatën e Apelit dhe se kjo sjellje e stafit të gjykatës përbën shkelje të nenit 187 par.1 të LPK-së andaj, kanë kërkuar që merren masa ligjore nga gjyqtarit .....dhe referentit .....

Me datë 04.02.2022, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar nga Xh. Sh. dhe I. N., të dy avokat në Prishtinë, ndaj gjyqtarit .....dhe referentit .....

Gjyqtari .....në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesve të ankesës ka deklaruar se në vazhden e tyre të përpjekjeve të pandërprera për ndikim në vendosje sipas dëshirës së tyre në lëndën C.nr.1392/20 i' a shtuan edhe kërkesën për marrjen e masave disiplinore ndaj tij si gjyqtar i çështjes për gjoja zvarritje të qëllimshme të dërgimit të lëndës me ankesë në Gjykatën e Apelit. Të gjitha thëniet e këtyre avokatëve janë tendencioze, qëllimkëqija e të pavërteta. Si gjyqtar i çështjes, ka theksuar se në afatin më të shpejtë ka vendosur lidhur me propozimin e caktimit të masës së sigurisë dhe menjëherë pas nxjerrjes së aktvendimit ia kemi ekspeduar nga një kopje të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse. I njëjti ka theksuar se me nxjerrjen e vendimit, si gjyqtar i çështjes e ka përfunduar pjesën e tij të punës dhe nuk është detyrë e tij që të interesohem se a shkon lënda në Gjykatën të Apelit për një orë, një ditë apo një muaj. Kjo është çështje administrative dhe nuk i përket atij si gjyqtar. Thëniet e të autorizuarve të paditësit Bashkim Shala se gjyqtari i çështjes qëllimisht nuk po e dërgon lëndën në Gjykatë të Apelit e me qëllim që ti mundësohet të paditurit ndërrimi i gjendjes në teren ku siç këta deklarojnë se objektin e kontestit i padituri dëshiron që ta shesë, gjyqtari ka theksuar se të njëjtit flasin të pavërteta për shkak se objekti i kontestit nuk është vërtetim i pronësisë por kthimi i mjeteve në shumë prej 5 milion euro. Qëllimi i të autorizuarve të paditësit është që tërë kohën ta fitojnë përshtypjen të pala e tyre se ata janë shumë profesional, të drejtë dhe se gjyqtari i çështjes qenka i njëanshëm dhe i ndikuar nga pala tjetër. Gjyqtari ka pohuar se sikur të ishte i ndikuar nga pala e paditur atëherë në procedurën e mëhershme në këtë lëndën gjyqtari njëherë ka vendosur meritorisht por, ai vendim është prish nga Gjykata e Apelit, i autorizuari i të paditurit M. Sh., avokati M. Sh. ka kërkuar përjashtimin e tij nga vendosja në këtë çështje kontestimore pasi që ka dyshuar në objektivitetin e tij si gjyqtar i çështjes meqenëse i autorizuari i paditësit ka qenë avokati Ramadan Shatri, i cili derisa gjyqtari Baloku ka qenë gjyqtar në Gjykatë të Istogut ka qenë Kryetar. Të njëjtët avokat kanë kërkuar përjashtimin e gjyqtarit më herët, kanë kontestuar të gjithë ekspertet që i ka caktuar nga lista e ekspertëve duke cek se te njëjtit qenkan 'njerëz të mi' të gjyqtarit të çështjes dhe janë të njëanshëm. Sipas këtyre avokatëve të gjithë qenkan kundër tyre. Përfundimisht, gjyqtari ka pozuar që pas shqyrtimit të kërkesës dhe deklaratës së tij, kërkesa për ndërmarrje të masave disiplinore ndaj tij të refuzohet si e pabazuar.

Referenti ....., lidhur me ankesën e parashtruar ndaj tij ka deklaruar se është e vërtet se në sportel ka ardhë njeri prej këtyre avokateve dhe është ankuar në të gjithë gjyqtaret e kësaj gjykate dhe në gjyqtarin e lëndës. Sa i përket lëndës, lënda është përgatit dhe dërguar më ankesë procedurale në kohë rekorde. Dua të përmendi edhe që zyra civile kontestimore punon më vetëm një referent i cili mundohet dhe del të punoj edhe të shtunave madje edhe të dielave pa pagesë, vetëm që lëndët në këtë zyre të punohen më kohë .

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit .....dhe referentit ....., së bashku me deklaratat e tyre, ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Parashtruesit e ankesës, në ankesën e tyre disiplinore kanë ngrit dyshimet se procedura e dorëzimit të ankesës së tyre në Gjykatën e Apelit, është duke u zvarrit me dashje dhe me qëllim dhe për interesa personale nga ana e referentit të gjykatës ..... dhe gjyqtarit .....

Në raport me ankesën disiplinore të parashtruar ndaj gjyqtarit Baloku, Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar veprimet e gjyqtarit dhe ka gjetur se i njëjti duke vepruar brenda kompetencave dhe autorizimeve të tij ligjore, sipas rregullit dhe duke respektuar afatet ka vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë dhe me vendimin e tij i ka njoftuar palët. Me njoftimin e palëve me vendim, gjyqtari ka përmbushur të gjitha obligimet e tij ligjore ndërsa, me rastin e parashtrimit të ankesës ndaj vendimit, është kompetencë e Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve Civile që lënda të kompletohet dhe të procedohet tutje në Gjykatën e Apelit.

Në raport me ankesën disiplinore të parashtruar ndaj referentit ....., Kryetari ka vlerësuar veprimet e referentit dhe ka gjetur se i njëjti me rastin e pranimit të ankesës ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në drejtim të plotësimit të prezumimeve ligjore për përcjellje të lëndës për vendosje nga gjykata e shkallës së dytë dhe sipas shkresave të lëndës, vërtetohet se lënda tashmë është proceduar në Gjykatën e Apelit për vendosje.

Nga të lartcekurat, Kryetari i Gjykatës gjeti se secili nga subjektet ndaj të cilëve është parashtruar ankesa disiplinore, ka ndërmarrë veprimet brenda kompetencave dhe autorizimeve të tyre, në afate të arsyeshme kohore.

Autoriteti kompetent, me vëmendje vlerësoj pretendimin e parashtruesve të ankesës për ekzistimin e dashjes dhe qëllimit të gjyqtarit Baloku dhe referentit ..... për mosprocedim të lëndës së tyre në Gjykatën e Apelit për vendosje dhe gjeti se pretendimet e tilla janë në kundërshtim me veprimet e ndërmarra nga gjyqtari dhe referenti, të cilat vërtetohen nga deklaratat e tyre por edhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat del se secili veç e veç, me kujdes dhe brenda afateve kohore të arsyeshme kanë ndërmarrë veprimet e tyre. Për më tepër, pretendimet e tilla të parashtruesve të ankesës, i bënë dukshëm të pabazuara edhe fakti se ankesa disiplinore mbështetet vetëm në supozime të cilat nuk janë mbështetë në asnjë provë të vetme që do t'i mbështeste dyshimet e ngritura se gjyqtari dhe referenti i kësaj gjykate në bashkëpunim, me qëllim dhe për interesa personale nuk e kanë dërguar lëndën në Gjykatën e Apelit.

Në rrethana të tilla, e në mungesë të provave, Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent, e pati të pamundur të vërtetojë ekzistimin e interesit personal dhe dashjes së gjyqtarit Baloku dhe referentit Begolli, që komplet lënda së bashku me ankesën e këtu parashtruesve të ankesës disiplinore të mos dërgohet në Gjykatën e Apelit andaj, ankesën e tillë e gjeti si dukshëm joserioze dhe të pabazuar.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.2/22, me datë 01.03.2022**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit .....*
- 3. Referentit .....*
- 4. Parashtruesve të ankesës – Xh. K.  
dhe I. N. – të dy avokat në Prishtinë*